

lajmi.net

Aksion i policisë në veri, kapet sasi e madhe e armatimit



05/09/2023 12:34

f

t

s

Policia e Kosovës ka ndërmarrë sot një aksion në Zveçan ku ka zbuluar sasi të madhe të armatimit.

Këtë e ka bërë të ditur Xhelal Sveçla, ministër i Brendshëm me anë të një postimi në Facebook, shkruan [lajmi.net](#).

Granata dore, armë automatike, fishekë e eksploziv janë zbuluar në këtë shtëpi ku u ndërmorr aksioni.

Postimi i plotë i Sveçlës:

Për 2 dekada, veriu i Kosovës ka jetuar në ilegalitet, në një rend anormal, ku kanë gjetur strehë organizatat kriminale e kriminelët e financuar nga Beogradi.

Kontrabandimi, hyrja ilegalisht e mallrave e armëve në Kosovë, ka prodhuar situatë shqetësuese edhe për qytetarët tanë në veri, të cilët të përballur me fuqinë e kriminelëve kanë jetuar nën shantazh e presion të vazhdueshëm.

Si Qeveri, gjatë 2 viteve të fundit, kemi zbuluar e bllokuar rrugët ilegale të kontrabandimit. Ditën e sotme, Policia e Kosovës së bashku me institucionet e inteligjencës, pas identifikimit, ka zhvilluar bastisje në një bazë të armatimit në veriun e Kosovës, konkretisht në Zveçan. Kjo shtëpi është përdorur për grumbullim dhe shpërndarje të armatimit për grupet kriminale serbe.

Deri më tani është zbuluar një sasi e madhe e armatimit, duke përfshirë armë automatike, fishekë, granata dore dhe eksploziv. Në vendin e ngjarjes, përveç institucioneve të sigurisë, kanë qenë të pranishëm edhe përfaqësues të KFOR-it.

Veriu hap pas hapi po shkon drejt normalitetit. Rendi dhe ligji nuk do të çënohet në asnjë cep të Republikës. [/Lajmi.net/](#)

Artikuj të ngjashëm



September 6, 2023
Kryetari i Zubin Potokut e bën vajzën drejtoreshë të komunës



September 6, 2023
Sot shënohet 24 vjetori i themelimi i Policisë së Kosovës



September 6, 2023
Shpërthen bombola e gazit, lëndohet burrë e grua



September 6, 2023
Kurti udhëton për në Estoni



September 6, 2023
Vazhdon gjykimi ndaj Thaçit dhe të tjerëve



September 5, 2023
Konjufca: Nëse ky është vullnet i opozitës dhe shumicës, pse të...

LAJME TË FUNDIT

- Megi Pojani prezantuese e edicionit të ri...
- Muja dhe Daku bëhen "gazetarë", intervistojnë njëri-tjetrin
- Rritet për 30% numri i turistëve që vizituan Kosovën
- Portieri i Milanit, Maignan: Unë jam parisien